



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Rruga: “Abdi Toptani”, ish-hotel “Drini”, Tiranë

Tel: 2268141; 04 2268142

Nr. 266 Prot.

Tiranë, më 10.04.2017

V E N D I M

Nr.78, Datë 10/04/2017

Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Bashkinë e Tiranës dhe ish komuna, aktualisht njësi administrative në përbërje të saj, dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nëpërmjet vendimit nr. 88, datë 04.09.2015 “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia e Tiranës”, Komisioneri ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes tematike në Bashkinë e Tiranës dhe ish komunat, të cilat aktualisht janë njësi administrative në përbërje të saj,

VËREJ SE:

Me vendimin nr. 88, datë 04.09.2015 “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia e Tiranës”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e procesit të mbikëqyrjes tematike në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Tiranë.

Për shkak të riorganizimit administrativo-territorial, shtrirja territoriale e Bashkisë së Tiranës, tashmë, përfshin edhe njësi vendore, të cilat kanë qenë të organizuara më parë si njësi të pavarura të qeverisjes vendore. Bëhet fjalë për 11 Njësitë Bashkiake të Bashkisë Tiranë dhe ish Komunitet Petrelë, Farkë, Dajt, Zall-Bastar, Bërzhitë, Krrabë, Baldushk, Shëngjergj, Vaqarr, Kashar, Pezë, Ndroq dhe Zall-Herr, të cilat aktualisht, në bazë të ligjit nr. 30/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar”, janë organizuar si njësi administrative, struktura dhe organika e të cilave, është pjesë e strukturës dhe organikës së administratës së bashkisë.

Në këto rrethana, kryerja e mbikëqyrjes në këtë institucion, e cila kishte për objekt plotësimin e kushteve ligjore të statusit të punësimin, të parashikuara në nenin 67 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në aktin nënligjor që rregullon procedurat e deklarimit të

statusit të punësimit, është shtrirë edhe në këto subjekte, të cilat aktualisht janë në përbërje të Bashkisë Tiranë.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 615/1 prot., datë 04.09.2015, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili me shkresën nr. 615/2 prot., datë 04.09.2015, *“Njoftim për fillimin e mbikëqyrjes”*, i është njoftuar Kryetarit të Bashkisë Tiranë.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në lidhje me procesin e deklarimit të statusit të punësimit të nëpunësve dhe e ka dërguar për njohje në subjektin e mbikëqyrur, nëpërmjet shkresës nr. 615/6 prot., datë 09.06.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, *“Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në Bashkinë e Tiranës, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”*, duke i lënë një afat 30 ditë kohë për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Gjatë procesit të verifikimit pranë njësive administrative, tashmë në përbërje të Bashkisë së Tiranës, grupi i mbikëqyrjes konstatoi disa parregullsi në kryerjen e procedurave të deklarimit të statusit të punësimit, nga ana e njësive përgjegjëse të Komunave, të cilat kanë qenë subjekt i ligjit për nëpunësin civil, para riorganizimit të njësive të qeverisjes vendore. Këto parregullsi kanë të bëjnë me aspekte të ndryshme të administrimit të këtij procesi, të cilat evidentohen më poshtë:

- ✓ Njësitë përgjegjëse të Komunave Krrabë, Shëngjergj dhe Zall-Herr nuk i kishin aplikuar në asnjë rast procedurat e deklarimit të statusit të punësimit, ndërsa njësia përgjegjëse e Komunës Bërzhitë, i kishte kryer procedurat vetëm për një pjesë të punonjësve.
- ✓ Për punonjësit të cilët nuk zotëronin një diplomë të arsimit të lartë, njësitë përgjegjëse të Komunave, nuk kishin nxjerrë vendim për përfundimin e marrëdhënies së punës me pozicionin e shërbimit civil, në të cilin ata ishin të emëruar, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit.
- ✓ Mungonin përshkrimet e punës, për pozicionet e shërbimit civil, sipas formularit standard të miratuar me vendimin nr. 142, datë 12.3.2014 *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar.
- ✓ Emërimet në kundërshtim me ligjin, në pozicione të shërbimit civil, të kryera pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, duke mos respektuar procedurat e rekrutimit, të parashikuara nga ky ligj.
- ✓ Mungesa të dosjeve të personelit, për punonjës të emëruar në pozicione të shërbimit civil, si dhe raste kur, dosja e personelit nuk ishte plotësuar me të gjitha të dhënat personale të karakterit teknik, profesional, si dhe të dhëna të tjera sipas lidhjes 1 dhe 2, bashkëlidhur vendimit nr. 117, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave *“Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”*.

Parregullsitë e konstatuara për çdo rast, si dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës, janë pasqyruar në mënyrë të detajuar në projektraportin e mbikëqyrjes. Subjekti i kontrolluar, pasi është njohur me to, me shkresën nr. 34756 prot., datë 14.11.2016, *“Kthim përgjigje”*, (protokolluar pranë Komisionerit me nr. 668 prot., datë 16.11.2016), ka dërguar

komentet përkatëse për të gjitha rastet e evidentuara si parregullsi në materialin paraprak të mbikëqyrjes.

Nisur nga përmbajtja e këtij materiali, provat e dërguara për të vërtetuar kryerjen e veprimeve të caktuara, si edhe nga verifikimet e mëtejshme të grupit të mbikëqyrjes, për të evidentuar vërtetësinë e akteve të dërguara me observacionet, rezultoi se deri në përfundimin e procesit të hartimit të raportit përfundimtar, njësia përgjegjëse e Bashkisë Tiranë, ka marrë masa për zbatimin e detyrave të materializuara në projektraport. Këto zhvillime, janë trajtuar në mënyrë të hollësishme në pjesët përkatëse të raportit përfundimtar dhe kanë të bëjnë kryesisht me realizimin e procedurave, për të rregulluar problemet të cilat i kemi evidentuar në hyrje të pjesës argumentuese të vendimit.

Sqarimet e dërguara nga subjekti i kontrolluar, si dhe provat shkresore që i shoqërojnë ato, janë administruar në dosjen e mbikëqyrjes.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, referuar Seksionit III, *“Procedura hetimore”*, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, si dhe Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes tematike, në lidhje me verifikimin e procesit të deklarimit të statusit të punësimit të nëpunësve, të cilët, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, ishin të punësuar në pozicione të shërbimit civil, në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Tiranë dhe Njësitë Administrative në përbërje të saj, i cili është pjesë e këtij vendimi.
2. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Tiranë, në kuptim të nenit 108 dhe 111, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, për punonjësen *****, duhet të anulojë aktin e nxjerrë për emërim në detyrë, si dhe aktet e nxjerra në kuadër të ristrukturimit të Bashkisë Tiranë, me argumentin se janë akte absolutisht të pavlefshme, pasi janë nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në kushtet kur ajo është emëruar në një pozicion të shërbimit civil, duke mos respektuar procedurat e kërkuara nga ky ligj.

Për ndreqjen e kësaj parregullsie, në zbatim të nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative, njësia përgjegjëse e Bashkisë Tiranë, duhet të anulojë aktin nr. 184, datë 05.03.2014 *“Për emërim në detyrë”* si dhe aktin nr. 17817 prot., datë 12.11.2015

“Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit”, të nxjerra për punonjësen *****
*****, me detyrë *“Specialist në Zyrën e Këshillit Bashkiak”*, në Bashkinë e Tiranës.

Pozicioni i saj i punës, duhet të shpallet pozicion i lirë dhe njësia përgjegjëse duhet të plotësojë këtë pozicion pune nëpërmjet procedurës së konkurrencës, në përputhje me përcaktimet e ligjit për nëpunësin civil.

3. Për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në lidhje me punonjësit, *****
*****, *****
*****, ***** dhe *****
*****, të cilët në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, nuk plotësonin kriterin e nivelit të diplomës së arsimit të lartë, për pozicionin e punës ku ata ishin të emëruar, njësia përgjegjëse e Bashkisë së Tiranës, duhet të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punës për këta punonjës.

Pozicionet e tyre të punës, duhet të shpallen të lira dhe të plotësohen nëpërmjet procedurës së konkurrencës, në përputhje me përcaktimet e ligjit të shërbimit civil.

4. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore, në bashkëpunim me eprorin direkt të pozicionit përkatës, të përfundojnë hartimin e përshkrimeve të reja të punës për të gjitha pozicionet e shërbimit civil, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar, lidhjeve pjesë e këtij vendimi dhe në përputhje me orientimet që janë dhënë në rubrikën përkatëse të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Njësia përgjegjëse e Bashkisë së Tiranës, të japë konfirmimin e saj, lidhur me përshkrimet e punës, për pozicionet që janë pjesë e shërbimit civil, nëse ato janë të hartuara në bazë dhe në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar, siç parashikohet në pikën 19, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014 të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar.

Pas marrjes së konfirmimit nga njësia përgjegjëse përshkrimet e punës të miratuara nga nëpunësi civil për të cilin është hartuar përshkrimi i punës, eprori direkt i pozicionit përkatës të punës dhe nëpunësi i punësuar në pozicionin ekuivalent me pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm, të bëhen pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil, një kopje të depozitohet në arkivin e institucionit dhe një kopje të depozitohet pranë njësisë përgjegjëse.

5. Njësia përgjegjëse e Bashkisë së Tiranës duhet të drejtojë procesin lidhur me konfirmimin ose jo të nëpunësve ***** dhe *****
*****, në përfundim të periudhës së provës, sipas orientimeve të lëna në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes.
6. Njësia përgjegjëse, në lidhje me pozicionin e punës *“Arkivist-Protokoll”*, në njësinë administrative përkatëse, të qartësojë raportin që ka ky pozicion me shërbimin civil dhe të materializohet shprehimisht në strukturën e institucionit. Në vijim, pasi të jetë përcaktuar

natyra e marrëdhënieve të punës në lidhje me këtë pozicion, të vijohet me trajtimin e tij, sipas ligjit që rregullon këtë marrëdhënie pune.

7. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **60** ditë nga marrja dijani për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
8. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, Bashkia e Tiranës, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
9. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë së Tiranës, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.
10. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA